



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. dokumentit: 21.1.1-2011-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË ZYRËS SË**  
**KRYEMINISTRIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR**  
**2011**

**Prishtinë, Qershor 2012**

## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	3
Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Hyrje.....	6
2 Opinioni i auditimit.....	7
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar.....	8
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar.....	9
5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit.....	12
6 Menaxhimi financiar.....	13
6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake).....	13
6.2 Shpenzimet.....	14
6.3 Pasuritë.....	19
6.4 Trajtimi i borxheve.....	20
6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor.....	21
7 Kontrolli menaxherial.....	22
7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm.....	22
7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm.....	22
8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e ZKM-së.....	24
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	25
Shtojca II. Gjendja e rekomandimeve nga viti i kaluar.....	27
Shtojca III. Komentet e ZKM-së dhe përgjigjja e ZAP-it.....	29

---

## Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
AK	Arkivi i Kosovës
AUV	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës
ABGJ	Agjencioni për Barazi Gjinore
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
KA	Komiteti i auditimit
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OB	Organizatë Buxhetore
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
SP	Sekretar i Përgjithshëm
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ
ZKM	Zyra e Kryeministrit

## Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës (më tutje ZKM) për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF-të.

*Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspekte materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtet.*

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj se informacioni i shpalosur mbi llogaritë e arkëtushme është jo i plotë.

Shpalosja jo e plotë e llogarive të arkëtushme nuk ndikon në opinionin mbi PVF-të e hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme (**ISSAI 400: Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes**).

Përkundër kësaj, ne kemi identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendësi të raportit.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontroleve të brendshme të ZKM-së është dizajnuar në mënyrë të duhur për eliminim e dobësive evidente. Por, ky sistem edhe më tutje ka nevojë për përmirësim në menaxhimin financiar dhe të kontroleve. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën e organizatës. Mangësitë që ndërlidhen me prokurimin, menaxhimin e pasurive janë çështje që tregojnë se ZKM duhet të zhvilloj më shumë llogaridhënien dhe transparencën për sa i përket veprimeve administrative. Gjithashtu vonesat e ndryshme, qoftë për sa i përket pagesave, mos zotimit me kohë të fondeve, mos mbylljes së avanseve kanë ndikuar në performancën e ZKM-së.

Ne rekomandojmë Kryeministrin që përmes Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së të rishikoj dhe analizoj sistemin ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara. Këtë ta bëjë në mënyrë që të funksionalizoj llogaridhënien dhe përgjegjësinë, në përputhje me detyrat e përcaktuara. Në koordinim me menaxherët e agjencive (AUV, AK dhe ABGJ), të ndërmarrin veprime konkrete për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

---

Në lidhje me këtë ne ju rekomandojmë që të siguroni:

- Rishikimin dhe analizimin e implementimit të sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të funksionalizoj llogaridhënien dhe përgjegjësinë në përputhje me detyrat e përcaktuara;
- Se në koordinim me menaxherët e agjencive vartëse, marrjen e veprimeve konkrete për adresimin e rekomandimeve të dhëna;
- Planifikim të buxhetit në bazë të një vlerësimi të qëndrueshëm dhe në përputhshmëri me nevojat reale të organizatës;
- Shpalosjen e llogarive të arkëtushme në PVF dhe të shpenzimeve në kode të sakta dhe adekuate për llojin e përcaktuar;
- Veprime konkrete për të zgjidhur çështjen e mos mbledhjes së borxheve që po përcillen prej disa vitesh radhazi;
- Kontrolle më të fokusuara për të eliminuar mangësitë në procesin e prokurimit dhe ekzekutimit të pagesave;
- Mbikëqyrje më të fokusuar rreth menaxhimit të avanseve për udhëtime zyrtare, duke siguruar mbylljen e tyre brenda 15 ditëve pas kthimit nga udhëtimi;
- Zhvillimin e procedurave të dokumentuara për menaxhimin e subvencioneve, përfshirë përcaktimin e kriterëve specifike dhe matëse për shpërndarjen (dhënien) e tyre;
- Mbajtje të plotë dhe të saktë të regjistrave të pasurisë dhe të siguroni që brenda një periudhe të shkurtër bëhet njehsimi fizik dhe raportimi adekuat i tyre; dhe
- Hartimin e statutit të NjAB-së dhe Komitetit të AB-së, përfshirë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të saj.

Menaxhmentit të ZKM-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund t'i gjeni në Shtojcën 3. Më tutje, menaxhmenti i ZKM-së është zotuar që do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Bazuar në auditimin tonë, ne besojmë dhe presim se në kohën e paraparë ju do të jeni në gjendje të trajtoni me kujdes të gjeturat tona dhe do të ndërmerrni veprime të duhura për t'i eliminuar ato.

---

# 1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF-të e ZKM-së për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e ZKM-së të përgatis PVF-të sipas kërkesave të Regullës Financiare nr.07/2011 (RrF) dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë, të institucionit tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të ZKM-së. Gjatë asaj faze të procesit të auditimit, kemi adresuar faktin se si i keni trajtuar rekomandimet e mëparshme, pasqyrat nëntëmujore dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Kemi këshilluar menaxhmentin. Kjo përfshinë edhe këshillat e dhëna për PVF. Memorandumi i auditimit, në rastin tonë është dorëzuar në Dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e ZKM-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF-të e ZKM-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe RrF nr.07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi PVF;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;

- Kemi kryer vlerësimin e kontrolleve të brendshme dhe testimin e tyre;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF-të e ZKM-së, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

## 2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspekte materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj se informacioni i shpalosur mbi llogaritë e arkëtushme është jo i plotë.

Shpalosja jo e plotë e llogarive të arkëtushme nuk ndikon në opinionin mbi P/F të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë se gatshme (**ISSAI 400: Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes**).

---

### 3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Raporti i auditimit për vitin 2010 ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime. ZKM ka përgatitur një Plan Veprimi, dhe është zotuar të marrë veprime për adresimin e të gjitha rekomandimeve.

Pavarësisht prej kësaj, ne kemi vërejtur se deri në fund të auditimit tonë, tri rekomandime janë adresuar plotësisht, ndërsa shtatë ishin ende në proces të adresimit.

Rekomandimet të cilat ende nuk janë adresuar në nivelin e duhur janë ato të mbledhjes së të hyrave nga qiraja, procesi i prokurimit, azhurnimi i dosjeve të personelit, pagesa e faturave me kohë etj. Adresimin në hollësi të rekomandimeve mund ta shihni të shpalosur në Shtojcën II.

#### **Konkluzion**

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve të mëhershme, ka shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Kjo tregon se ZKM duhet të përqëndrohet më shumë në veprime të përshtatshme për të përmirësuar situatën për sa i përket fushave ende të pa adresuara. Shprehim shqetësimin tonë për të gjitha rekomandimet që nuk janë adresuar plotësisht.

#### **Rekomandimi 1**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Merr veprime konkrete për adresim të duhur të rekomandimeve dhe t'i kushtoj më shumë vëmendje adresimit të tyre.



## 4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Vjetore Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

**Tabela 1. Burimet e fondeve Buxhetore-aktuali ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2011 Të shpenzuara	2010 Të shpenzuara
Burimet e fondeve buxhetore. Gjithsej:	8,817,086	10,005,550	7,642,190	9,483,469
Granti i Qeverisë - buxheti	8,817,086	8,795,246	6,779,013	7,819,286
Të hyrat vetanake	-	350,871	244,099	290,306
Donacionet e brendshme	-	469,663	231,420	353,131
Donacionet e jashtme	-	389,769	387,658	1,020,746

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë shihet se ekziston ndryshimi në rritje në kategoritë e shpenzimeve nga buxheti fillestar në buxhetin final. Rritja e buxhetit është bërë me vendime të Qeverisë.

Ndërsa, shpenzimet e realizuara për vitin 2011 ishin 7,642,190€ apo 76% e buxhetit final.

Kjo tregon se buxheti i shpenzuar nuk është në përputhje me planifikimin e bërë me ligjin e buxhetit.

**Tabela 2. Shpenzimi i fondeve sipas kategorive ekonomike - aktualisht ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimi i fondeve sipas kategorive - Gjithsej:	8,817,086	10,005,550	7,642,190	9,483,470
Paga dhe Mëditje	2,727,448	3,006,623	2,591,845	2,338,439
Mallra dhe Shërbime	2,102,790	3,007,410	2,543,889	3,252,328
Shpenzimet Komunale	197,298	128,370	115,215	119,837
Subvencionet dhe Transferet	1,360,000	1,167,785	951,811	1,118,311
Investimet Kapitale	2,429,550	2,695,361	1,439,429	2,654,553

Ngritja e buxhetit final në raport me atë fillestar të Pagat dhe Mëditjet ka ardhur si rezultat i vendimit për rritjen e numrit të stafit në kabinetin e zv.Kryeministrave, por edhe për fondet e kuadrove.

Ngritja e buxhetit final në raport me atë fillestar për Mallra dhe Shërbime ka rrjedhë në bazë të vendimit të qeverisë për themelimin e grupit për bisedime teknike me Serbinë.

Po ashtu në buxhetin fillestar nuk janë përfshirë të hyrat vetanake dhe donacionet. Kjo ka ndikuar që të gjitha kategoritë e shpenzimeve të kenë ngritje në buxhetin final.

Tek kategoria e Subvencioneve ka zvoglim të buxhetit final në raport me atë fillestar. Kjo ka rrjedhë si rezultat i kalimit të Agjencionit të Mërgatës bashkë me buxhetin e saj në Ministri të Diasporës.

Nivel i ulët i shpenzimeve të realizuara në raport me buxhetin vërehet sidomos te investimet kapitale në Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës (AUV), ku plani është realizuar në kuotën 53%.

Faktorët që kanë ndikuar në uljen e buxhetit final në raport me buxhetin fillestar dhe një realizim të ulët të shpenzimeve janë:

- Vonesë në aprovimin e Ligjit për buxhetin e vitit 2011;
- Në AUV nuk janë zhvilluar procedura inicuese paraprake nga njësitë kërkuese për fillimin e prokurimit; dhe
- Vonesa dhe dështime në procedurat e (blerjeve) prokurimit në AUV si rezultat i kërkesës së OSHP-së për rivlerësim ose ritenderim të lëndëve.

**Tabela 3. Pranimet e mbledhura për Buxhetin e Kosovës-aktuali ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Gjithsej pranimet	-	-	4,312,513	4,807,293
Të hyrat vetanake	-	-	3,973,745	4,260,832
Të hyrat nga donacionet			338,768	546,461

Tabela 3 prezenton të hyrat e realizuar nga ZKM, AUV dhe AK. Këto të hyra nuk ishin përfshirë në librin e buxhetit. Për më shumë informata rreth menaxhimit të të hyrave referoju kapitullit 6.1 (të hyrat).

### **Konkluzion**

Ne konkludojmë që trendi i ulët i ekzekutimit të buxhetit në raport me planin, ka ardhur si rezultat i planifikimit jo adekuat. Kjo tregon se ky planifikim ka qenë i pa bazuar në nevoja dhe kërkesa reale. Një shkaktar tjetër shtesë ishte edhe vonesa në aprovimin e buxhetit. Si rrjedhojë e kësaj ne konkludojmë se ZKM-AUV, nuk kanë arritur të sigurojnë menaxhim të buxhetit në përputhje me objektivat e përcaktuara në fillim të vitit.

### **Rekomandimi 2**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm siguron:

- Planifikim të buxhetit në bazë të një vlerësimi të qëndrueshëm dhe në pajtueshmëri me nevojat dhe kërkesat; dhe
- Kryerjen e rishikimeve të rregullta (p.sh. mujore) të shpenzimeve aktuale ndaj planit për t'i identifikuar arsyet për ndryshimet e theksuara dhe adresimin si duhet të problemeve.

## 5 Pasqyrat vjetore financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësia e informacionit

Bazuar në kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe Rregullën Financiare (RrF) 07/2011, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- ZKM ka përgatitur PVF-të në pajtueshmëri me RrF 07/2011 dhe kërkesa të tjera;
- PVF-të janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar dhe janë dorëzuar në thesar brenda afatit kohor me datën 30.01.2011;
- Nga kategoria e investimeve kapitale në AUV, janë proceduar pagesa për shpenzime të ndryshme për mallra dhe shërbime si: furnizim me numra identifikues për kafshë, furnizim me vaksina, furnizim me material për zyrë dhe material të shtypur, etj. Nga gjithsejt pagesat e testuara në ZKM, në tetë (8) prej tyre kemi vërejtur se pagesat nuk janë evidentuar në kode adekuate. Në prezantimin e mëposhtëm në raport do t'i shpalosim disa raste;
- PVF-të janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe.

Përkundër kësaj ne kemi vërejtur:

- Mungesë të informacionit në PVF për sa i përket prezantimit të llogarive të arkëtushme të Arkivit të Kosovës, siç kërkohet tek shënimin 34. Gjithsej llogaritë e arkëtushme në fundvit të AK-së janë 33,600€.

### Konkluzion

PVF-të e ZKM-së në përgjithësi janë në pajtueshmëri me kërkesat e kornizës së aplikueshme raportuese. Informatat kryesisht janë të plota dhe të sakta. Përrjashtim nga kjo edhe pse nuk është materiale bën regjistrimi i shpenzimeve në kode jo adekuate dhe prezantimi i të arkëtushmeve në PVF.

### **Rekomandimi 3**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Të kërkoj kontrole adekuate që sigurojnë planifikim më të mirë të procesit buxhetor në përputhje me nevojat e organizatës;
- Përkujdeset që shpenzimet e evidentuara të jenë në përputhje me kode të sakta dhe adekuate për llojin e përcaktuar; dhe
- Përmes menaxhmentit të AK-së do të ndikoj që Llogaritë e arkëtueshme të prezantohen në PVF.

## 6 Menaxhimi financiar

### 6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)

ZKM, gjatë vitit 2011 ka realizuar të hyra në vlerë prej 4,312,514€. Prej tyre 3,973,745€ janë të hyra vetanake, ndërsa 338,768€ janë nga donacionet. Të hyrat vetanake janë realizuar nga:

**Tabela 4. Burimet e të hyrave vetanake** (në €)

Nr	Të hyrat e realizuara	Shuma në €
1	Zyra e Kryeministrit	256,311
2	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës	3,710,900
3	Arkivi i Kosovës	6,534
Totali i të hyrave		3,973,745

Ne kemi vërejtur se ekziston një harmonizim i plotë ndërmjet raporteve të Thesarit dhe atyre të ZKM-së. Një harmonizim i tillë ekziston edhe ndërmjet raporteve të brendshme të entitetit dhe të hyrave të prezentuara në PVF.

ZKM realizon të hyra nga: qiraja dhe gazeta zyrtare<sup>1</sup>. Të hyrat e mbledhura nga ZKM-ja kalojnë drejtpërdrejt në Buxhetin e Kosovës, ato nuk shfrytëzohen nga ZKM-ja.

AUV i realizon të hyrat nga: inspektimi fitosanitar, sanitar, veterinar, shërbimet e dezinfektimit, shitja e mallrave nga konfiskimet dhe dënimet, si dhe të hyrat nga taksat administrative<sup>2</sup>. Por, në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes MF dhe ZKM-AUV është lejuar që 345,597€ të shfrytëzohen nga AUV. Kjo të bëhet për mbulimin e shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si dhe mallrave dhe shërbimeve.

Arkivi Kosovës (AK) i realizon të hyrat nga ofrimi i shërbimeve për dokumentat arkivore dhe nga lëshimi i objektit me qira<sup>3</sup>.

Testimet tona kanë evidentuar mangësi në trajtimin e të hyrave. Mangësitë e identifikuar po i shpalosim në vijim.

<sup>1</sup> Të hyrat nga qiraja janë në vlerë 197,605€, ndërsa nga gazeta zyrtare janë 58,706€.

<sup>2</sup> Të hyrat nga inspektimi fitosanitar, sanitar dhe veterinar në kufi dhe brenda janë 3,251,791€, nga dezinfektimi 76,083€. Të hyrat nga shitja e mallrave 39,127€, ato nga dënimet dhe konfiskimet 44,774€, ndërsa ato nga taksat administrative 299,124€.

<sup>3</sup> Të hyrat nga ofrimi i shërbimeve për dokumente arkivore 6,790€, si dhe nga qiraja 455€.

### Nivel i ulët i inkasimit të të hyrave nga qiraja

Bazuar në marrëveshjen në mes UNMIK-ut dhe INA (industrisë së naftës), kjo e fundit shfrytëzon me qira pasurinë publike, respektivisht objekte për depozitimin e naftës. Si kundërvlerë e kësaj, ZKM realizon të hyrat nga qiraja në vlerë mujore 22,000€. Po sipas kësaj marrëveshje, ZKM bën faturimin për çdo muaj. Ndërsa INA është e detyruar të përmbush obligimin brenda 45 ditëve.

Ne kemi vërejtur se INA nuk i ka përmbushur të gjitha obligimet e parapara sipas marrëveshjes. Si pasojë e kësaj borxhi i akumuluar deri me 31.12.2011 ishte 176,000€. Është për t'u theksuar se kjo çështje është duke u përsëritur vite me radhë dhe ka qenë pjesë e rekomandimeve tona nga vitet e kaluara.

Po ashtu, AK realizon të hyra nga dhënia e objekteve me qira për institucionet tjera publike. Shuma e faturuar gjatë vitit 2011 ishte 19,200€. Ndërsa inkasimet ishin vetëm 455€. Gjithsej obligimet e qiramarrësve ndaj Arkivit në vitin 2011 ishin 33,600€ duke përfshirë edhe borxhet nga vitet paraprake.

### **Konkluzion**

Konkludojmë se ZKM nuk ka arritur të përmbush planet e pritura për të hyrat . Dështimi për të mbledhur të hyrat nga qiraja tregon se ZKM nuk ka marrë masat e duhura që do të ndihmonin në mbledhjen e tyre.

#### **Rekomandimi 4**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Ndërmerr veprime konkrete për të zgjidhur çështjen e mos mbledhjes së borxheve që po përcillen prej disa vitesh radhazi.

## 6.2 Shpenzimet

### 6.2.1 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Gjatë vitit 2011 në ZKM, dhe agjencionet vartëse të saj ishin të punësuar 461 punonjës në vitin 2011. Shpenzimet për paga dhe mëditje ishin 2,591,845€.

Ne kemi testuar gjithsej nëntë (9) mostra. Nga testimet e kryera ne nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi që do të duhej adresuar.

Po ashtu edhe dosjet e personelit kanë qenë të kompletuara me të gjitha dëshmitë dhe evidencat e e nevojshme.

## 6.2.2 Prokurimi

Në vitin 2011, ZKM përmes procedurave të prokurimit ka shpenzuar gjithsej 2,688,937€. Ne kemi përzgjedhur gjithsej 28 mostra nga pagesat e ndodhura në SIMFK në vlerë prej 568,010€ dhe 15 mostra nga kontratat e prokurimit në vlerë prej 521,405€ për testim. Testet tona kanë rezultuar me disa të gjetura, të cilat po i shpalosim në vijim:

### Planifikim jo i mirë për furnizime

Të lënda "Furnizim me shtypin ditor" me vlerë të kontratës 73,530€, kemi vërejtur që planifikimi i bërë për këtë blerje kap vlerën prej 12,000€. Para fillimit të procedurave të prokurimit është bërë disponueshmëria e mjeteve me vlerë prej 50,000€. Nga kjo vërejmë që kontrata ka një vlerë dukshëm më të lartë nga ajo që është planifikuar. Shkak i kësaj është planifikimi jo i mirë i kontratës.

### Inicimi i procedurave të prokurimit pa kërkesë paraprake dhe mungesë e dëshmive për arsyet e shfrytëzimit të furnizimeve

Te lënda "Furnizim dhe shërbime"<sup>4</sup> për ZKM-në në vlerë të një pagesë 10,810€, kemi vërejtur se nuk është iniciuar kërkesa nga njësia kërkuese për iniciimin e blerjeve. Për më tepër, në procesverbalin e pranimit nuk përshkruhet se cilat janë arsyet e shfrytëzimit të furnizimeve dhe shërbimeve të blera.

Te kjo lëndë gjithashtu kemi vërejtur se janë bërë tejkalime të sasisë së blerë në raport me atë të kontraktuar. Në një nga faturat e testuara të kësaj kontrate nga 11 pozicione sa ishin paguar, 6 prej tyre janë tejkaluar në sasi. Sasia e blerë më tepër është 11,940 njësi ose 2,260€ (23%).

Si arsye e tejkalimeve të tilla dhe mos planifikim i mirë i sasisë së nevojshme para lidhjes së kontratës, mund të dëmtojë buxhetin.

### Vonesa në ekzekutimin e pagesave ndaj OE-së

Neni 39.1 i LMFP-së, përcakton që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara ose punët e realizuara për OB, duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të saj ose kërkesës për pagesë.

<sup>4</sup> Përshkrimi furnizimeve: Folje vetëngjitëse, dizajnimi i posterave B2, postera, fletushka, memorandum, bine me dim. 6m x3m, fasiklla.

Te lëndët në vijim kemi vërejtur se ka pasur vonesa në ekzekutimin e pagesave siç janë:

- Te lënda "Furnizimi me gazeta zyrtare", në vlerë 2,284€, fatura është pranuar me datën 23.08.2011, ndërsa pagesa është kryer me 18.10.2011.
- Te lënda "Reklama dhe Konkurse" në vlerë 4,315.€, fatura është pranuar me datën 04.11.2010, ndërsa pagesa është kryer me 20.01.2011.
- Te lënda "Shërbime të përkthimeve" në vlerë 12,930€, fatura është pranuar me datën 15.12.2010, ndërsa pagesa është kryer me 14.03.2011.
- Te lënda "Furnizim me shtypin ditor" në vlerë 2,093€, fatura është pranuar me datën 06.01.2011, ndërsa pagesa është kryer me 11.03.2011.

Ekzekutim i pagesës pa poseduar raportin për kryerjen e shërbimeve

Gjatë testimit të lëndës "Shërbime për përkthime", në vlerë 7,463€ kemi vërejtur se është ekzekutuar pagesa ndaj OE-së, edhe pse mungon raporti i pranimit për kryerjen e shërbimeve. Po ashtu te kjo lëndë mungon kërkesa nga njësia kërkuese për iniciimin e procedurave të blerjes. Mungesa e këtyre dëshmimeve na bën të pamundur që të sigurohemi se shërbimet e kërkuara janë pranuar si duhet.

Evidentimi i gabuar i llojit të shpenzimeve

- Te një rast "Furnizim me material për zyre dhe material të shtypur për AUV", me vlerë 52,587€, lënda ka të bëjë me furnizim me mallra dhe shërbime, ndërsa në SIMFK është paguar dhe evidentuar në kategorinë e investimeve kapitale.
- Tek lënda "Renovimi i objekteve" në AUV me vlerë 83,489€, kemi vërejtur që për punët e realizuara me këtë kontratë është bërë regjistrimi në kodin ekonomik mirëmbajtja e ndërtesave. Natyra e shpenzimit ka qenë në kategorinë e investimeve kapitale;
- Lëndët "Furnizim me numra identifikues për kafshë" në AUV me vlerë 100,000€ dhe "Furnizim me vaksina" në vlerë 66,000€ kanë të bëjnë me furnizim me mallra dhe shërbime. Shpenzimet janë paguar dhe evidentuar në kategorinë e investimeve kapitale.

Mosrespektimi i kritereve të caktuara në dosjen e tenderit

Tek lënda "Furnizim me material për zyre si dhe material të shtypur" në vlerë 52,587€, në dosjen e tenderit një nga kriteret e kërkuara për përzgjedhjen e OE-së ka qenë qarkullimi bankar për tri vitet e fundit si dhe leja e punës.

Kemi vërejtur se OE i cili është përzgjedhur fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm. Në dosje të tenderit atij i kanë munguar dokumentet e kërkuara.



### Shpenzimet e reprezentacionit

Gjatë testimi të lëndës “Shpenzimet e reprezentacionit” në ABGJ në vlerë 1,000€, kemi vërejtur që i është bërë pagesa OE-së në bazë të faturës në të cilën është specifikuar ushqimi për 150 persona. Ndërsa në listën e pjesëmarrësve ne kemi vërejtur se në këtë konferencë figurojnë vetëm 52 persona.

### Mungesë e vendimit mbi themelimin e komisionit për pranim të mallit

Gjatë testimi të dy pagesave në lëndën “Furnizim me numra identifikues për kafshë” në AUV me vlerë 99,999€ dhe 38,333€, kemi vërejtur që janë nënshkruar të gjitha fletëpranimet për mallin e pranuar, nga disa zyrtarë. Mirëpo këta zyrtarë nuk kanë ndonjë vendim ku specifikohet që janë të caktuar si komision për pranim të mallit. Po ashtu kemi vërejtur që personat që kanë pranuar mallin ndryshojnë për çdo furnizim.

### **Konkluzioni**

Të gjeturat e mësipërme tregojnë se proceset e prokurimit nuk ishin kryer gjithmonë në pajtim me rregullat. Blerjet nuk janë bërë në kohën dhe mënyrën e duhur. Regjistrimi në kategoritë ekonomike nuk është gjithmonë ai i duhuri. Ne mund të konkludojmë se kontrollet e brendshme në këtë fushë nuk kanë funksionuar si duhet. ZKM ka ende nevojë për përmirësime në procesin e prokurimit, menaxhimin financiar dhe kontrolleve.

### **Rekomandimi 5**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Ndërmerr veprime që mundësojnë se inicimit të procedurave për blerje i paraprin kërkesa e bërë nga njësia kërkuese e bazuar në nevojat përkatëse dhe qëllimet e organizatës;
- Nxiti kryerjen e pagesave me kohë të faturave të pranuar, brenda periudhës së paraparë (30 ditë), ose në të kundërtën të arsyetohen vonesat në mënyrë të dokumentuar;
- Ndërmerr kontrolle shtesë në vlerësimin e tenderëve për të siguruar përzgjedhje të ofertave në bazë të kriterëve të përcaktuara; dhe
- Ndërmerr kontrolle që sigurojnë se pagesat janë në përputhshmëri me shërbimin e pranuar.

### 6.2.3 Blerjet tjera

#### *Vonesa në mbylljen e avanseve;*

- Ne kemi vërejtur se ZKM gjatë procesit të menaxhimit të avanseve nuk kishte arritur të bëjë mbylljen e tyre me kohë. Avanset e pa mbyllura në fundvit ishin në vlerë prej; 82,010€. Nga kjo 78,230€ i takonin ZKM-së dhe 3,780€ agjencioneve vartëse të saj. Disa raste të vonesave janë shpalosur në vijim:
- Vizitë zyrtare e delegacionit të ZKM-së në Shqipëri nga data 28-30.06.2011 në vlerë 2,000€.
- Vizitë zyrtare e delegacionit të ZKM-së në Bruksel nga data 26-29.09.2011 në vlerë 15,000€.
- Vizitë zyrtare e delegacionit të ZKM-së në Kroaci nga data 07-09.2011 në vlerë 7,500€.
- Vizitë zyrtare e delegacionit të ZKM-së në Zvicër nga data 26-03-05.04.2011 në vlerë 5,000€. dhe
- Vizitë zyrtare e delegacionit të ZKM-së në SHBA nga data 26-11-07.12.2011 në vlerë 6,950€.

#### **Konkluzioni**

Konkludojmë se ZKM nuk ka zhvilluar kontrolle të duhura për sa i përket mbylljes së avanseve për udhëtime zyrtare.

#### **Rekomandimi 6**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Shton masat e mbikqyrjes për të garantuar mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare brenda 15 ditëve pas kthimit nga udhëtimi.

### 6.2.4 Subvencionet dhe Transferet

Nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve për vitin 2011 ishin shpenzuar 951,811€ ose 82% e vlerës së planifikuar. ZKM ka ofruar subvencione për entitetet publike, jopublike, pagesa për përfituesit individual etj.

Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve ishin 239 transaksione në shumë totale prej 951,811€. Prej tyre, ne kemi testuar gjithsej tetë (8) mostra në vlerë prej 373,140€, ose 40% e shumës. Kemi vërejtur mungesë të politikave dhe kriterëve për dhënien dhe menaxhimin e tyre.

ZKM nuk ka përcaktuar marrëveshje të qarta për mënyrën e dhënies dhe shfrytëzimit të subvencioneve dhe transfereve.

Në tri raste të dhënies së subvencioneve në vlerë 36,245€, ZKM nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për mënyrën e dhënies dhe shfrytëzimit të tyre.

### **Konkluzion**

Çështjet e ngritura për sa i përket dhënies dhe shfrytëzimit të subvencioneve tregojnë se ZKM në disa raste nuk ka arritur të sigurojë procedura të duhura për dhënien e subvencioneve. Kjo ka ndikuar që edhe kontrolli i brendshëm të mos funksionoj për të parandaluar mundësinë e dhënies dhe shfrytëzimit të tyre në mënyrë të gabuar.

#### **Rekomandimi 7**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Merr veprime për zhvillimin e procedurave të qarta që përcaktojnë mënyrat dhe kriteret matëse të dhënies së subvencioneve; si dhe
- Inicon kontrolle më të mira të bazuara në marrëveshjet lidhur me shfrytëzimin dhe raportimin e subvencioneve të dhëna.

## **6.3 Pasuritë**

### **6.3.1 Trajtimi i pasurive kapitale dhe jo-kapitale**

Lista e pasurive të ZKM-së dhe agjencioneve vartëse të saj përmban një vlerë neto të pasurive prej 4,302,979€.

Ne kemi rishikuar regjistrin kontabël të ZKM-së, përfshirë edhe agjensionet vartëse, regjistrin e përgjithshëm, si dhe kemi vlerësuar menaxhimin e tyre, nëse është në pajtim me U.A. nr. 21/2009 - Mbi Regjistrimin dhe Menaxhimin e Pasurive Qeveritare. Ne kemi vërejtur se:

- Regjistri i përgjithshëm i pasurive në ZKM dhe Agjensionet vartëse nuk i përmban të gjitha elementet siç kërkohet me UA. Në regjistër, mungojnë barkodi dhe numri serik.
- Njehsimi fizik (Inventarizimi) i pasurisë në AUV nuk është bërë për vitin 2011.

## Konkluzion

Mungesa e evidencave të plota mbi pasurinë tregon se ZKM nuk ka arritur të përmbush si duhet kërkesat për identifikim dhe raportim financiar. Si rezultat i kësaj ZKM nuk ka qenë në gjendje të siguroj se pasuritë e prezantuara në PVF përmbajnë informacionet e duhura.

### Rekomandimi 8

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Siguron se drejtori i AUV kryen inventarizimin; duke bërë të mundur që ZKM të prezantojë informatat saktë në pasqyrat nëntë mujore; dhe
- Merr masa për vendosjen e barkodeve menjëherë për të gjitha pasuritë.

## 6.4 Trajtimi i borxheve

Obligimet e pa kryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishin në vlerë 212,476€. Nga kjo vlerë, obligimet e ZKM-së janë 127,774€, AUV-it 46,120€, AK 24,861€, ABGJ-së 12,120€ dhe Këshilli i Sigurisë 1,601€.

Obligimet e pakryera, kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të reprezentacionit, furnizim me derivate, telefonisë fikse, bileta udhëtimi etj.

Arsyeja kyçe, për mos kryerje me kohë të obligimeve, sipas zyrtarëve përgjegjës ka qenë vonesa në pranimin e faturave..

## Konkluzion

Obligimet e mbetura tregojnë se ZKM dhe agjensionet vartëse të saj nuk kanë bërë si duhet monitorimin e procesit të ekzekutimit të kontratave dhe buxhetit në tërësi.

### Rekomandimi 9

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Krijon parakushtet për parashikim më të mirë dhe monitorim të fondeve të përcaktuara për shpenzime.

---

## 6.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Ne vlerësojmë se ZKM ka përmbushur edhe obligimet për raportim të jashtëm, si:

- Gjatë vitit 2011, ZKM ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF-së;
- Ka dorëzuar me kohë në MF Pasqyrat Nëntëmuajore Financiare;
- Ka dorëzuar me kohë në MF/Thesar raportet mujore mbi borxhet e krijuara;
- Ka dorëzuar me kohë në ZAP planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të auditimit; dhe
- Plani preliminar dhe përfundimtar i prokurimit është hartuar dhe dorëzuar në Agjensionin e Prokurimit Publik.

### **Konkluzioni**

Veprimet e kryera për sa i përket kërkesave të raportimit aktual të jashtëm janë të mjaftueshme.

## 7 Kontrolli menaxherial

### 7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Në përgjithësi ZKM ka një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm që determinon mjedisin e kontrollit. ZKM ka të strukturuar nivelet e përgjegjësive dhe të llogaridhënies brenda organizatës. Mirëpo të gjeturat tregojnë se sistemet nuk janë implementuar si duhet.

Përmes testimeve tona në fusha të ndryshme, të shpalosura më lartë që ndërlidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm, ne vlerësuam funksionimin e këtij sistemi. Nga kjo ne identifikuam mangësi në fushat si në vijim:

Menaxhimi i procesit dhe procedurave të prokurimit ende përcillet më mangësi në disa aktivitete. ZKM gjithashtu përballet me mangësi në planifikimin dhe realizimin e projekteve kapitale, procedurave të dhënjes së subvencioneve dhe transfereve, mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare me kohë si dhe bartjen e obligimeve në vitin pasues.

#### Konkluzioni

Mangësitë e theksuara për sa i përket çështjeve që ndërlidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm tregojnë se ky sistem nuk është duke funksionuar në të gjitha segmentet e tij si duhet. Duhet theksuar edhe më tutje se mangësitë për planifikim, procedura të prokurimit, subvencione dhe transfere, avanse për udhëtime zyrtare, janë çështje kyçe në të cilat ZKM duhet fokusuar.

#### **Rekomandimi 10**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Përforon kontrollin e brendshëm në fushat me dobësi të theksuara, identifikon faktorët që kanë ndikuar në ndodhjen e tyre dhe merr veprime konkrete për të eliminuar ato.

### 7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

ZKM ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB). Ajo është e përbërë vetëm nga Drejtori i kësaj njësie.

NJAB ka përgatitur një plan vjetor për vitin 2011 dhe një strategjik të auditimit për periudhën 2011-2013. Në planin vjetor janë paraparë të realizohen 5 (pesë) auditime.

ZKM ka formuar Komitetin e Auditimit (KA) në vitin 2009, në përbërje prej tre anëtarëve. Në Korrik 2011, Komiteti është ri themeluar për shkak të mungesës së një anëtari, me vendim të Kryeministrit. KA, gjatë vitit kishte mbajtur vetëm një takim të rregullt, në të cilin është analizuar puna e NjAB-së si dhe implementimi i rekomandimeve është diskutuar.

NjAB dhe KA nuk e kanë hartuar statutin e auditimit i cili do të ndihmonte në realizimin e objektivave dhe qëllimeve të NjAB-së.

NjAB ka hartuar raporte tre mujore, raportin vjetor për auditimet e kryera dhe aktivitetet e AB-së. Ato i ka dorëzuar më pas në Njësinë Qëndrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB).

Raportet e kryera janë përcjellur me gjetje dhe rekomandime për sa i përket fushave të cilat janë mbuluar.

Përkundër kësaj, për gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së, ZKM nuk ka nxjerrë plane konkrete të veprimit për implementim nga departamentet përkatëse.

### **Konkluzioni**

Përgjithësisht, gjatë vitit 2011 shihet një progres për sa i përket punës së NjAB-së dhe KA-së. Mirëpo, ende nuk është bërë sa duhet rreth planeve konkrete për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB-ja.

#### **Rekomandimi 11**

Rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Siguron se NjAB, në koordinim me KA përgatit statutin e auditimit me qëllim të rritjes së funksionalitetit të kësaj njësie;
- Shton takimet e KA-së, me qëllim të rritjes së funksionalitetit të NjAB-së; dhe
- Përgatit planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së, dhe ndërmerr hapat e nevojshëm për implementimin e tyre.

## 8 Një konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e ZKM-së

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se kishte një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm. Mirëpo, në disa raste ZKM ende nuk ka arritur që t'i implementoj kontrollet në tërësi. Kjo do të mbështeste menaxhim efektiv dhe efikas të parasë publike.

Mangësitë që ndërlidhen me prokurimin, menaxhimin e pasurive janë çështje që tregojnë se ZKM duhet të zhvilloj më shumë llogaridhënien dhe transparencën.

Gjithashtu vonesat e ndryshme, qoftë për sa i përket pagesave, mos zotimit me kohë të fondeve, dhe mangësitë në trajtimin e pasurive kanë ndikuar në mosefikasitet dhe mosefektivitet.

### **Rekomandimi i përgjithshëm**

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Rishikon dhe analizon implementimin e sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të funksionalizoj llogaridhënien dhe përgjegjësinë në përputhje me detyrat e përcaktuara; dhe
- Në koordinim me menaxherët e agjencive vartëse, ndërmarrin veprime konkrete për adresimin e rekomandimeve të dhëna.



---

## Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca II. Gjendja e rekomandimeve nga viti i kaluar

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Plotësisht të implementuara	Pjesërisht të adresuar	Të pa adresuara
Adresimi i rekomandimeve	Është duke u kushtuar më shumë vëmendje adresimit të rekomandimeve të dhëna.		Nuk janë adresuar tërësisht rekomandimet	
5. Pasqyrat vjetore Financiare	Cilësia e informatave	Blerjet mbi 1000€ janë evidentuar në regjistrin kontabël të thesarit	Evidentimi i shpenzimeve në kode adekuate	
VI.1 Të hyrat	Arkëtimin e mjeteve të faturuara			Arkëtimi i mjeteve të faturuara për lëshimin e objekteve me qira.
VI.2.1 Shpenzimet	Blerjet përmes procedurave të prokurimit	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Pranimi i paisjeve në përputhje me kontratë .</li> <li>2.Realizimi i punimeve pa kontratë.</li> <li>3.Mospërputhje midis çmimeve në faturë dhe kontratë.</li> <li>4.Procesimi i Urdhërblerjes pa nënshkrimin e menaxherit të prokurimit</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Mungesë e dëshmimeve në procedurat e prokurimit.</li> <li>2.Përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre operatorëve të përgjegjeshëm.</li> <li>3.Ekzekutimi pagesave pa poseduar me dokumenta përkatëse.</li> </ol>	

2.3 Kompensimet Paga dhe Mëditje	Mos azhurnimi i dosjeve të personelit me kohë	Të gjitha dosjet janë azhurnuar me kohë.		
2.5 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Mos regjistrimi i pasurive në regjistrin kontabël dhe regjistrin e përgjithshëm të pasurisë.	Të gjitha pasuritë janë evidentuar në regjistrat e pasuairsë		
2.6 Borxhet	Pagesat e faturave me vonesë			Nuk janë marrë masat e duhura
2.4 Subvencione dhe transfere	Mungese e politikave dhe kriterëve për dhënjen e subvencioneve			
VII.1 Sistemet e kontrolleve të Brendshme	Permisim të funksionimit të kontrollit të brendshëm		Në disa fusha ka progres në eliminimi e dopsive por nuk janë eliminuar të gjitha dopsitë	
VII.2 Auditimi i brendshëm	Mbajtje të takimeve të rregullta të Komitetit të auditimit		Ka një takim të Komitetit ,edhe për kundër faktit të riformulimit me vonesë	

## Shtojca III. Komentet e ZKM-së dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të ZKM-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme janë si më poshtë.

REKOMANDIMET	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Komentet nga ZKM-ja	Komentet e ZAP-it
Rekomandimi 5:		X		<p>Lënda për "Furnizim me shtypin ditor" Gjithashtu kontrata në fjalë është kontratë kornizë bazuar ne nenin 38 te LPP-së, andaj kontratat kornizë, lejojnë qe te gjithë artikujt e kontraktuar mund të porositen apo mos te porositen fare nga ana e Autoritetit kontraktues.</p> <p>Planifikimi është bërë ne fillim te vitit, ndërsa sasia e planifikuar për prokurim është rritur duke u bazuar në rritjen e stafit politikë te ZKM-së dhe kërkesat reale qe ishin janë akoma.</p> <p>Pajtohem pjesërisht Tek vërejtja e dytë tek lënda "Furnizim me numra identifikues për kafshë në AUV" dhe tek lënda tjetër "Furnizim me vakcina" është po ashtu e njëjta çështje. Këto të dy lëndë kanë të bëjnë në kuadër të investimeve kapitale sepse janë projekte të investimeve</p>	<p>E gjetura jonë ka të bëjë me proces të planifikimit jo të mirë. Prandaj konkluzioni i auditorit qendron dhe rekomandimi mbetet me tutje për adresim.</p> <p>Pajtohem me faktin që ka pasur kërkesë nga ana e juaj të MF-i për kategorizimin e buxhetit në linja përkatëse buxhetore (shpenzimeve) . Por ky problem nuk është zgjidhur. Prandaj ne rekomandojme që edhe me tutje të bashkëpunoni me MF-, si dhe të</p>

			<p>edhe për këto janë paraqitur. Kështu që AUV ka bërë këto shpenzime në linjën buxhetore - Kapitale të cilat nga natyra janë në përgjithësi si mallra dhe shërbime. Ky shpenzim nga linja buxhetore kapitale është duke vazhduar vit pas viti. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në vitin 2011 (30.05.2011) me një shkresë ju ka drejtuar MF, Z, Agim Krasniqit duke e përshkruar situatën e mjeteve të ndara në linjën buxhetore - Kapitale e që nga natyra e shpenzimeve janë mallra dhe shërbime, kemi kërkuar që disa Projekte të AUV - të aprovohen në kodin mallra dhe shërbime e jo në kapitale, mirëpo është e pamundur që të ndodhë një gjë e tillë, kështu që edhe këtë vit është duke vazhduar e njëjta situatë me shpenzim të buxhetit nga linja buxhetore - kapitale. Të gjitha këto shpenzime janë të planifikuara dhe përshkruara brenda Projekteve të AUV në sistemin e PIP-it, dhe se na është thënë edhe në dëgjime buxhetore në vitin e kaluar se bëni shpenzim aty ku i keni mjetet e buxhetuara.</p> <p>Dëshmitë: Lënda me numër 259033 janë bërë shpenzimet për blerje të materialit të shtypur në kuadër të projektit të Identifikimit dhe Regjistrimit, ndërsa lënda me numër 200703 ka të bëjë me mallra dhe shërbime, po me të njëjtën kontratë. Po ashtu edhe lënda me numër 311264 blerja e numrave identifikues është bërë nga projekti i Identifikimit dhe Regjistrimit.</p> <p>Ndërsa sa i përket pikës - Renovimi i objekteve në AUV -</p>	<p>dokumentoni faktoret që ndikojnë në mos implementimin buxhetit në kategoritë perkatese ( natyres se shpenzimit.</p> <p>Në memorandum parashihet që këto mjete të shpenzohen në Mallra dhe Shërbime. Si dhe janë evidentura në këtë kategori (shpenzimet e mirëmbajtjes). Por natyra e shpenzimit është investim kapital. Prandaj duhet të ketë kujdes të shtuar që në bazë të natyre se shpenzimit mjete të buxhetohen</p>
--	--	--	--	---

			<p>mjetet buxhetore janë ndarë nga realizimi i të hyrave vetanake dhe se MF këto mjete i ka aprovuar në mallra dhe shërbime për mes një Memorandumi të Mirëkuptimit për shfrytëzimin e një pjese të mjeteve (të cilin Memorandum ua kemi prezantuar gjatë fazës së auditimi në AUV) në të cilin janë përfshirë që të bëhet shpenzim nga mallrat dhe shërbimet.</p> <p>Renovim të 6 zyrave regjionale</p> <p>Pastrim dhe mirëmbajtje të Objekteve të AUV-ës.</p> <p>AUV - prapë do të ngritë këtë çështje të aprovimit të Buxhetit të vitit 2013 për disa Projekteve të AUV që të na i kalojë mjetet nga Kapitale në kategorinë Mallra dhe Shërbime në mënyrë që mos të marrim vërejtje nga auditor vit pas viti për të njëjtën arsye. Dëshmitë: Ekstraktin e takimit të mbajtur në MF me datën 30.04.2007Shkresën e datës 30.05.2011 - Drejtuar Z, Agim Krasniqit. Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga Ministri i Financave.</p>	dhe të realizohen.
--	--	--	--	--------------------

Më tutje, menaxhmenti i ZKM-së është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.